

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shpopullimi - Numri i nxënësve në qarkun e Korçës po tkurret/ Këtë vit gati 700 më pak në bankat e shkollës
ADRESA	https://www.syri.net/sociale/916467/numri-i-nxenesve-ne-qarkun-e-korces-po-tkurret-kete-vit-gati-700-me-pak-ne-bankat-e-shkolles/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 07:20:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 07:13:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3ee05d6e6299f56842748a17ea198933e47b946a1808da515ec9a5b971270639
TEKSTI	d60bd546af32222c8570a1b2a1c0d0f209c037d32b0a09b1a26d60291a796b16
PAMJA	e89e3b44e6364386868ac9bd00e5fc8f757055c4b63733e6563461ccf9d175f2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	26a73d6bf6e576b4b804686cc7f4fa9fc585c37c4c389516b4dc69d76aa432fc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ac1c8d986ca8a5982bfff13c00b3f40fb9a36fbd6d516390a812a54ba861f1b0b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/26a73d6bf6e576b4b804686cc7f4fa9fc585c37c4c389516b4dc69d76aa432fc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**IRENA BEQIRAJ**Fashizmi nuk duhet kërkuar
tek revolta e protestuesve por
në Kuvend!**AGIM XHAFKA**

Dialog me mbësën



më të lexuarat

SYRI TV/ Pas ngujimit në zyra, Bankers
tërhiqet, banorët arrijnë marrëveshje me
firmënHoroskopi, 13 shtator/ Zbulo çfarë
parashikojnë yjet për secilën shenjëParashikimin e motit për sot -
Temperaturat ulen deri në 29 gradëShqipëria po përballet me çmime
ushqimore më të shtrenjta se mesatarja
europiane! TVSH-ja, ndër më të lartat në
BEBrenda kolapsit të agjencisë së
surrogacisë që u kushtoi grave surrogate
dhe prindërve të ardhshëm ëndrrat e
paratë e tyreVIDEO/ Elbasan, tension në Këshillin
Bashkiak, opozita: Fondi i emergjencave
nuk po përdoret nga mungesa e
planifikimit

Numri i nxënësve në qarkun e Korçës po tkurret/ Këtë vit gati 700 më pak në bankat e shkollës

09:13, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Viti i ri shkollor nis me rënie të numrit të nxënësve në qarkun e Korçës. 52 nxënës më pak do të ulen këtë vit të ri shkollor në klasat e para dhe 680 nxënës më pak në total.

Sipas të dhënave zyrtare për vitin shkollor 2026–2027, në klasën e parë janë regjistruar 1351 nxënës, nga 1403 që ishin një vit më parë. Pra, bankave të klasave të para këtë shtator u mungojnë 52 nxënës, ose rreth 3.7% krahasuar me vitin e kaluar.

Thuaje i pandryshuar paraqitet numri i nxënësve që nisin gjimnazin. Në klasat e dhjeta janë regjistruar 1566 nxënës, vetëm 3 më pak se 1569 që rezultonin në vitin shkollor 2025–2026.

Në arsimin bazë dhe atë të mesëm, këtë vit shkollor në qarkun e Korçës rezultojnë 18,448 nxënës. Një vit më parë numri ishte 19,128. Brenda vetëm një viti, sistemi arsimor i qarkut numëron kështu 680 nxënës më pak, një rënie prej rreth 3.6%.

Pavarësisht tkurrjes së numrit të nxënësve, sipas informacionit zyrtar, asnjë prej 2117 mësuesve në qark nuk ka mbetur pa ngarkesë mësimore. Ndryshimet e bëra në udhëzimin për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore vlerësohet se kanë ndikuar në reduktimin e rasteve të mësuesve pa ngarkesë.

Ndërkohë sipas informacioneve të marra në rrugë zyrtare nga DRAP Korçë në këtë fazë nuk rezultojnë asnjë shkollë e miratuar për mbyllje dhe as klasa të mbyllura. Procesi i sistemit vijon, ndërsa në disa raste nxënësit janë ende duke u transferuar nga një shkollë në tjetrën.

Të dhënat e këtij fillimviti shkollor konfirmojnë megjithatë një prirje që po bëhet gjithnjë e më e dukshme: numri i nxënësve në qarkun e Korçës po tkurret, ndërsa vetëm në harkun e një viti nga bankat e shkollave janë larguar 680 nxënës. /Raportio gazetaria e Syrit, Sidorela Xhomaqi/

© SYRI.net

Lexo edhe:



Pesimizmi, dashuria dhe paratë – Ja çfarë kanë rezervuar yjet në këtë 14 shtator



Berati po boshatiset/ Bie ndjeshëm numri i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, dhe ata që hyjnë në klasën I



Shpopullimi në qarkun e Elbasanit/ Viti i ri shkollor nis me më pak fëmijë në bankat e klasës së parë

Sot priten reshje shiu në të gjithë territorin, njihuni me parashikimin e motit dhe sa do të jenë temperaturat

Parashikimi i horoskopit 12 shtator, ja çfarë kanë rezervuar yjet për ju sot

PISA 2025/ Si u deformuan të dhënat nga qeveria, reagon OECD: Nuk i miratuum ndryshimet

TË NGJASHME



Shpopullimi/ Në qarkun e Fierit më pak nxënës në banka! Shkollat në periferi e ato rurale drejt boshatisjes



E hëna nis me diell e freski – Ja parashikimi i motit për sot



Sot viti i ri shkollor! Mbi 340 mijë nxënës në të gjithë vendin, 25 mijë prej tyre ulen për herë të parë në banka



SYRI TV/ Përmblyte nga shiu i rrëmbyer në Elbasan, banorët kërkojnë ndihmë emergjente



Shqipëria po përballet me çmime ushqimore më të shtrenjta se mesatarja europiane! TVSH-ja, ndër më të lartat në BE



Këshillat e ekspertëve: 5 gjëra që nuk duhet t'i ndani me ChatGPT



Parashikimin e motit për sot - Temperaturat ulen deri në 29 gradë

LAJME POLITIKE KRONIKE EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.